



Federata e Pavarur e Sindikatave
F.S.P.E.
Nr. 203 dt. 18.02.2020
Prishtine

Nr. 095/20
Data 15.02.20

FEDERATA E SINDIKATAVE TË PAVARURA ELEKTROKOSOVA – FSPE Federation of Independent Trade Union Elektrokosova - FITUE

Të nderuar anëtarë të Bordit të ZRRE-së,

Fillimisht ju falënderojmë për bashkëpunimin e ngushtë dhe profesionalizmin që keni me të gjitha palët dhe trajtimin e kërkesës sonë gjatë vitit 2017. Megjithëse ZRRE ka aprovuar drejtësisht një pjese të kërkesës sonë, punonjësit e KEDS dhe KESCOendendodhen larg përfitime krahasuar me sektorin publik.

Duke marrë parasysh se jeni në procesin e rishikimit të të Hyrave Maksimale të lejuara për vitin 2020 dhe së shpejti do të merrni vendim për to, të cilat do të ndikojnë dhe përcaktojnë pagat tona për këtë vit relevant, ne me mirësjellje kërkojmë nga ju që të pasqyrojnë në mënyrë të drejtë pagat e punonjësve të KEDS dhe KESCO në të njëjtin nivel si kolegët tanë që punojnë në të njëjtin sektor në Kosovë (KEK dhe KOSTT), por edhe në rajon.

Që nga privatizimi, kompania jonë ka rritur shërbimet e saj dhe respektivisht volumi i punëve është rritur jashtëzakonisht shumë. Konsumatori jo vetëm që është rritur në numër për mbi 30% por edhe është vetëdijesuar duke kërkuar shumë më shumë përgjegjësi ndaj shërbimeve të ofruara. Si rezultat edhe presioni për të punuar më shumë e më efikas është rritur ndjeshëm. Megjithatë, rritja e volumit të punëve dhe presionit nuk është rritur në mënyrë lineare me pagat të cilat mbesin ende nën-mesataren e sektorit. Kjo është edhe njëri ndër faktorët me demotivues për punonjësit tanë, të cilët vazhdimisht po kërkojnë rrugëdalje tjera, e ajo me e shprehura është migrimi në vendet evropiane, ku fuqia punëtore po vlerësohet.

Rritja e vazhdueshme e çmimeve të konsumit, inflacioni dhe shtrenjtimi i jetës në përgjithësi e bën të vështirë për ne si mbajtës të familjes t'i përmbushim nevojat themelore për familjet tona. Shtuat kësaj edhe presionin dhe ambientin shpesh të rrezikshëm dhe stresues të punës, është shumë jo-motivuese për punonjësit të vazhdojnë tutje duke e dhënë maksimumin e tyre në të mirë të kompanisë dhe sektorit në përgjithësi.

Duke pasur parasysh se shumica e punonjësve që punojnë në KEDS dhe KESCO shërbejnë për më shumë se 20 vjet, ne me krenari kemi shërbyer kompanisë dhe vendit drejt fazave të ndryshme të zhvillimit dhe besojmë se ne meritojmë asgjë më paksesa të paguhemi në mënyrë të ngjashme me pozitat tjera me të njëjtën ngarkesë dhe përgjegjësi në sektorin e energjisë në Kosovë, por të cilët punojnë për sektorin publik.

Ne tashme kemi mbajtur disa takime me menaxhmentin tonë, ku kemi shprehur shqetësimet dhe kërkesat tona, por ata kanë argumentuar se janë të përballur me rritje të vazhdueshme të kostove, shërbimeve përderisa

ekziston një faktor efikasiteti i cili ne baza vjetore zvogëlon shpenzimet e lejuara operative, andaj mundësitë për të ofruar rritje të pagave brenda buxhetit të lejuar nga ju si rregullator është pothuajse e pamundur. Andaj marr parasysh se jeni në proces të përcaktimit të kostove për vitin 2020 ne kërkojmë me mirësjellje nga rregullatori të konsiderojë e sindikatës sëpunëtoreve të KEDS/KESCO, si në vijim:

**Ngritje në përputhshmëri me KEK -- KOST për tu barazuar me paga meqense jemi një hallk zingjirorë
Të largohet faktori efikasitetit, dhe**

Të lejohet një shtesë për primin e sigurimit shëndetësor, meqenëse sigurimi shëndetësor aktual mbulon vetëm sigurimin bazik dhe punëtorët janë të obliguar të paguajnë shtesat në forme vetanake nëse duan të përfitojnë nga njëprim më i mirë i sigurimit shëndetësor. Duam të sqarojmë se kërkesat e lartë-shënuara janë nevoja bazike dhe nuk pasqyrojnë kërkesat e plota tëpunëtorëve, megjithatë kjo rritje është e nevojshme dhe do të vlerësohej si motivuese për punëtorët e kompanisë, e për më tepër do të zbuste edhe dallimin ndaj sektorit publik. Kjo e fundit veçanërisht ka rritur shume pakënaqësinë e punëtorëve, të cilat megjithatë për një të mirë më të përgjithshme kanë vazhduar t'i shërbejnë popullit duke ofruar energji elektrike për të gjithë në Kosovë. Pra, punëtorie i pakënaqur dhe shpesh i zhgënjyer megjithatë ka vënë interesin e vendit para vetes dhe ka vazhduar të punojë duke shpresuar nga viti në vit se munda i tij do të shpërblehet.

Marr parasysh bashkëpunimin tuaj të mirë dhe gatishmërinë për të reflektuar drejtë mbi të gjithë pjesëmarrësit e sektorit me të vërtetë besojmë në përgjigjen tuaj pozitive.

Në këtë kuptim, do të vlerësojmë lartë mundësinë që të takohemi me ju për të diskutuar kërkesën tonë për rritjen e pagave, të cilat fuqimisht besojnë se janë në përpjesëtim me performancën tonë aktuale.

Ne jemi shumë mirënjohës që jemi pjesë e kësaj kompanie dhe gëzohemi që përmes punës sonë të vështirë kontribuojmë për të ndriçuar vendin tonë.

Faleminderit për kohën dhe konsideratën tuaj! Në pritje të përgjigjes suaj! Sinqerisht, Sindikata e Punëtorëve të KEDS dhe KESCO

Prishtinë 18.02.2020

